

Përshëndetje znj. Topi!

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, adresuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet adresës zyrtare elektronike: kontakt@issh.gov.al, referuar pyetjeve që keni parashtruar, ju informojmë si në vijim:

- ***Sa është numri i pensionistëve në skemën e sigurimeve shoqërore: sa prej tyre përfitojnë pensione urbane dhe sa rurale? Sa është vlera e pensionit urban dhe sa e atij rural? Të dhënat të jenë për 5 vitet e fundit, përfshirë edhe vitin 2025.***

PENSIONI MESATAR

	2021	2022	2023	2024	9-mujori 2025
pensione urbane numer	566,423	585,809	608,581	630,143	657,412
pleqërie	460,214	481,420	503,747	525,421	552,512
invaliditeti	62,036	61,348	60,956	60,517	60,312
familjare	44,173	43,041	43,878	44,205	44,588
pensione rurale numer	107,390	101,114	96,418	91,256	87,725
pleqërie	96,803	91,316	86,902	82,146	78,907
invaliditeti	6,143	5,819	5,636	5,410	5,245
familjare	4,444	3,979	3,880	3,700	3,573
pensione total numer	673,813	686,923	704,999	721,399	745,137
pleqërie	557,017	572,736	590,649	607,567	631,419
invaliditeti	68,179	67,167	66,592	65,927	65,557
familjare	48,617	47,020	47,758	47,905	48,161
Pensioni urbane (mesatar ne leke)					
pensione pleqërie	17,258	17,350	18,341	19,609	20,192
pensione invaliditeti	15,064	15,939	17,270	19,039	19,760
pensione familjare	7,460	8,118	8,558	9,160	9,424
Pensioni rural (mesatar ne leke)					

pensione pleqërie	9,656	10,349	11,051	11,878	12,228
pensione invaliditeti	8,195	8,280	8,677	8,966	10,638
pensione familjare	2,516	2,237	1,884	1,771	1,770

Pensioni mesatar (urban+Rural ne leke)

pensione pleqërie	15,875	16,184	17,233	18,519	19,157
pensione invaliditeti	14,431	15,262	16,534	18,199	19,021
pensione familjare	6,983	7,600	8,004	8,574	8,844

**Pensioni
mesatar
urban(leke)**

16,215	16,500	17,528	18,810	19,409
--------	--------	--------	--------	--------

**Pensioni
mesatar
rural(leke)**

9,261	9,902	10,546	11,298	11,709
-------	-------	--------	--------	--------

- ***Cilat janë kushtet për të përfituar një pension pleqërie? A ka ndonjë politikë të veçantë për të reduktuar pensionet e pjesshme?***

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ushtron veprimtarinë e tij, në zbatim të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore dhe trajton çështjet kontribut/përfitim për kategorinë që ligjvënësi ka përcaktuar detyrime të kësaj natyre (pagesën e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore).

Ligji Nr. 7703/1993, me hyrjen në fuqi më datë 01.10.1993, krijoi një sistem të detyrueshëm publik, i cili ndër të tjera solli një mbrojtje tërësore të sigurimeve shoqërore. Sigurimi shoqëror i detyrueshëm, si pjesë e sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore, mbështetet në parimin kontributiv “Paguaj sot, që të përfitosh nesër”. Mbi këtë parim, por edhe në parimet universale, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në aktet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes shoqërore të ratifikuara, është ndërtuar fasha e mbrojtjes me të ardhura dhe përfitime të kontribuesve të kësaj skeme, në rastin e pakësimit të të ardhurave për shkaqe sëmundje, barrëlindje, aksidente në punë, sëmundje profesionale, invaliditeti, pleqërie, humbja e mbajtësit të familjes etj.

Parimi kontributiv i sistemit të sigurimeve shoqërore, është të ofrojë mbrojtje me të ardhura, bazuar në masën dhe periudhën e kontributit. Skema e sigurimeve shoqërore ka si koncept trajtimin mbi parimin e barazisë të kontribuesve, sipas historikut kontributiv të zhvilluar gjatë jetës së tij, pra realizon ndërtimin e një lidhje të drejtë kontribut-pension.

Pika 1, e nenit 31, e ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, parashikon se: “Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji”.

Sipas kësaj dispozite ligjore, cilido që ka plotësuar minimalisht 15 vite periudhë sigurimi shoqëror dhe ka arritur moshën e parashikuar në nenin 92, të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, mund të përfitojë pension pleqërie.

- *A mbulohen pensionet nga skema e sigurimeve shoqërore apo ka nevojë për mbështetje buxhetore nga qeveria? Nëse po sa është vlera e kësaj mbështetje?*
- *Cila është skema e varësisë së kësaj skeme, a është ajo e rrezikuar në të ardhmen, për shkak të plakjes së popullsisë? Cilat janë masat që po merren për të siguruar që Fondi i Sigurimeve Shoqërore të jetë i qëndrueshëm dhe të mund të mbulojë rritjen e numrit të pensionistëve?*

NORMA E VARËSISË SË SISTEMIT NVS1) (Pensionistë / Kontribues)

	2020	2021	2022	2023	2024
Norma e Varësisë së Sistemit					
për pensionet në total	0.88	0.85	0.85	0.84	0.85
urbane	0.77	0.76	0.78	0.79	0.82
rurale	2.53	1.92	1.68	1.31	1.06
Norma e Varësisë së Sistemit					
për pensionet e pleqërisë	0.72	0.70	0.70	0.70	0.71
urbane	0.61	0.61	0.64	0.66	0.68
rurale	2.27	1.73	1.52	1.18	0.95

Raporti Kontribues / Pensionistë

Numri i kontribuesve për 1 pensionist					
për pensionet në total	1.14 : 1	1.18 : 1	1.18 : 1	1.19 : 1	1.18 : 1
për pensionet e pleqërisë	1.39 : 1	1.44 : 1	1.42 : 1	1.42 : 1	1.41 : 1

- *Për pensionistët që kanë një pension më të ulët, sidomos ai rural, a ka ndonjë program për mbështetje shtesë nga ISSH?*
- *Sa ishte vlera e bonusit të shpërndarë për pensionistët dhe kush e përfitoi?*

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 27.11.2024 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2024”:

Përfituan shpërblimin, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, personat, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të

Shqipërisë”, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat që përfitojnë pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

c) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”;

ç) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar, si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, ‘Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar’”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

dh) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nuk janë të punësuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

e) Personat që përfitojnë pension, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

ë) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar;

f) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar; **g)** Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Përfituan shpërblim, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, personat, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie, me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, mbi masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

- c) Personat që përfitojnë pension, me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”;
- ç) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë;
- d) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm, të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- e) Personat që nuk përfitojnë pension sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar, të caktuar sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;
- ë) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve, që kanë punuar në metalurgji”, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë).

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 9.1.2025 “Për mbështetjen financiare të pensionistëve për vitin 2025”,

Përfituan shpërblimin, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, personat, sipas kategorive të mëposhtme:

- a) Personat që përfitojnë pension pleqërie, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;
- b) Personat që përfitojnë pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;
- c) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”;
- ç) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- d) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar, si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, ‘Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar’”,

si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

dh) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nuk janë të punësuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

e) Personat që përfitojnë pension, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

ë) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar;

f) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar; **g)** Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Përfituan shpërblim, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, personat, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie, me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, mbi masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

c) Personat që përfitojnë pension, me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

ç) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë;

d) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm, të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) Personat që nuk përfitojnë pension sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar, të caktuar sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

ë) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve, që kanë punuar në metalurgji”, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë).

- Kryeministri Rama ka deklaruar reformim të skemës së pensioneve në Shqipëri si do të ndikojnë këto reforma në pensionistët e aktualë dhe ato të ardhshëm?